



2022

RAPORT – TM3-2022



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR”

SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com

PËRMBAJTJA


Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”		4
I.	RAPORTI I DEPARTAMENTIT TEKNIK	5
1.1	Performancat	5
1.1.1	Situata e furnizimit – TM3 - 2022	5
1.1.2	Aktivitetet kryesore	6
1.1.3	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	10
1.1.4	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	10
1.1.5	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	10
II.	RAPORT I DEPARTAMENTIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	12
2.1	Performancat	12
2.1.1	Numri i Konsumatorëve – TM3-2022	12
2.1.2	Faturimi m3- TM3-2022	13
2.1.3	Faturimi €- TM3-2022	14
2.1.4	Arkëtimi €- TM3-2022	15
2.2	Komentet kryesore nga DPK- TM3 - 2022	16
2.2.1	Aktivitetet kryesore- TM3 - 2022	16
2.2.2	Raport i ankesave teknike dhe komerciale	16
2.2.3	Raport i Ekipes së inspektimit dhe shkyçjes	16
2.2.4	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	17
2.2.5	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	17
2.2.6	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	18
III.	RAPORT I DEPARTAMENTIT FINANCIARË	19
3.1	Aktivitetet kryesore – TM3 - 2022	19
3.2	Arsyeshmëria e shpenzimeve – TM3 - 2022	20
3.3	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	21
3.4	Masat e realizuara nga periudha paraprake	22
3.5	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	22
3.6	Transaksionet kryesore	23
3.7	Pasqyrat financiare	24

IV.	RAP. I DEPARTAMENTIT ITUN	25
	4.1 Fushëveprimtaria- ITUN	25
	4.2 Statusi i projektit – masat shoqëruese	25
	4.3 Aktivitet kryesore	25
	4.4 Problemet e evidentuara	29
	4.5 Masat e realizuara/ mos realizuara	29
	4.6 Masat e propozuara	29
V	RAP. I DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	31
VI	RAP. I AUDITORIT TË BRENDSHËM	39
VII	RAP. I PROKURIMIT	40
	ORGANOGRAMI	43

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

KRU" HIDROREGJIONI JUGOR" Sh.A Prizren

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit, viti 2022



LEGJENDA:	
05	Zona e shërbimit
05	Qytetet me ujë
75	Fshatrat me ujë që menaxhohen nga HRJ
118	Venbanimet pa shërbime të ujësjellësit

Punoi: Shërbimi TEKNIK


I. RAPORT I DEPARTAMENTIT TEKNIK

1.1 PERFORMANCAT - KRU „ HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A – PRIZREN

PRODHIMI – TM3 2022

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

TM1-TM2-TM3- 2022						
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN						
PRODHIMI - m3						
NJËSIA PUNUESE	TM1-2022		TM2-2022		TM3-2022	
	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	313.8	2,440,100	379.9	2,987,000	454.7	3,574,850
SUHAREKË	79.3	616,252	91.4	718,300	103.6	814,302
MALISHEVË	42.2	328,179	47.4	372,577	46.7	367,375
DRAGASH	32.8	255,294	31.0	244,063	33.3	262,134
TOTAL	468.1	3,639,825	549.7	4,321,940	638.3	5,018,661
NDRYSHIMI l/sec			21.63	682,115	88.61	696,721
NDRYSHIMI %				18.74%		16.12%



1.1.1 SITUATA E FURNIZIMIT

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes për muajt Korrik-Shtator të vitit 2022, në nivel regional, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë i plotë dhe i rregullt me përjashtime të

vogla dhe të pjesshme të furnizimit në disa lokalitete nga ndërprerjet e energjisë elektrike apo problemeve të natyrshme të shfaqura në puset furnizuese. Furnizimi stabil dhe i kënaqshëm vije si rezultat i kushteve të volitshme atmosferike për resurset dhe kapacitetet ujore sikurse dhe investimeve të vazhdueshme në pëmirësimin e rrjetit në përgjithësi me theks të veçantë në zonat problematike të furnizimit.

Në muajt Korrik-Shtator, kemi realizuar furnizimin stabil, kualitativ dhe kuantitativ duke përmbushur standardet aplikative për furnizim 24h dhe cilësi 100 % të ujit të pijes dhe duke ndërmarrë në vazhdimësi aktivitetet e duhura në operim dhe mirëmbajtje për funksionim optimal të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

1.1.2 AKTIVITETET KRYESORE

- Angazhimet dhe menaxhimet e përditshme të punëve në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e vendit të punës dhe jashtë tij për operim dhe funksionim optimal të Departamentit Teknik dhe Kompanisë.
- Takimet e rregullta të menaxhmentit, me bashkëpunëtorët, me donatorët, me institucionet komunale, qeveritare, me konsumatorët etj.
- Përgjigjet, raportet dhe shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike, harmonizimi i projekteve investive dhe dokumentacioneve perkatese teknike me të gjitha Institucionet financiare e tjera, perpilimi dhe finalizimi i projektpropozimeve të përgatitura nga DT.
- Menaxhimi i projekteve të investimeve kapitale sipas planifikimeve të PB 2022, të përfunduara dhe ato në realizim e sipër.
- Hartimi dhe menaxhimi i Marrëveshjeve bashkëinvestimi me komunën e Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.
 1. Projekti studimor dhe investiv për furnizim me ujë të pijes për Prizrenin nga burimet Vërmica, Poslishti dhe Sozi – Nashec.
 2. Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në rr. „Edit Durham “ – Prizren
 3. Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në rr; „Nëna Tereze “ – Prizren
 4. Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e pusetave dhe ujëmatësave jashtë pronës private në fshatin Zhur – Prizren.
 5. Gypsjellësi □ 400 mm në zonat e qytetit të Prizrenit,
 6. Rrjeti i ujësjellëst në zonën „Nënkalaja “ – Prizren,
 7. Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Rr. Xhavit Sylja “-Suharekë,
 8. Vendosja e ujëmatësave dhe aftësimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Peqan – Suharekë.
 9. Rehabilitimi i njësisë së koagulimit e filtrimit dhe burimit Radesha në Dragash

- Shqyrtimi dhe analizat profesionale te sistemeve elektropompuse, përpilimi i projektdokumentacionve investive per elektropompa, vegla pune dhe makineri e mekanizëm përcjellës. Evidentimi i makinerisë dhe gjendjes së tyre në nivel të Kompanisë për klarifikimin e nevojave për investime të reja dhe asgjësimin e makinerisë jashtë përdorimit përkatësisht me amortizim të skaduar.
- Planifikimet strategjike, auditimet dhe evaluimet teknike me bashkepunetoret e DT te raporteve per institucionet kompetente dhe projekteve te paperfunduara, ato ne ekzekutim e siper, aplikacionet softwerike dhe menaxherialenë zbatim të Kompanisë, etj.
- Aplikimi dhe procedimi i shkresave zyrtare qe leshon DT - Pergjigjeve ne kerkesa, Dhënia e kushteve teknike, Lejeve, Vendimeve dhe Pelqimeve konform Rregulloreve te Kompanise.
- Vazhdimi i kryerjes së detyrave të punës nga pozicioni paraprak ne cilesine e menaxherit te projekteve dhe menaxhimi i kontratave me Telekom, IPKO, KEDS e operator tjerë, evidentimi dhe procesimi për pagesë të shpenzimeve mujore energjetike e telekomunikuese, ofrimin e zgjidhjeve teknike, hartimin e paramasave e parallogarive, kujdesi për mbartëvajtjen operative të infrastrukturës fizike të njësive punuese të Kompanisë.

Aktivitet e departamentit teknik të ndermarrura për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjeter të qytetit për eleminimin e hubmjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për dedektim.
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajn ujin në menyre që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve në sherbime dhe investime për sherbim sa me efikas të furnizimit me ujë të pijes.

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Korrik - Shtator, 2022

Njësia Operative	Ujësjellësi - uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	416	195	611
Suharekë	128	40	168
Dragash	17	14	31
Malishevë	128	22	150
Total	689	271	960

Zyra për planifikim dhe zhvillim – Korrik - Shtator, 2022

- * Përpilimi i pëlqimeve, përgjigjeve në kërkesa për konsumatorët.
- * Takime me inxhinierat e njesive për pasurimin e GIS-it.
- * Përpilimi i Planit për menagjimin e Krizave (Urim Bytyqi).
- * Përpilimi i projekt propozimeve nga HRJ (Projektet Investive Kapitale).
- * Takim në D.Sh.P – Prizren, Investimet Kapitale.
- * Sqarim për ARRU-auditimi i vitit 2021.
- * Inicimi i projekteve për realizmi.
- * Menaxhimi i kontratave në sistemin e Prokurimit.
- * Takime në KRU-të, Plani për menaxhimin e asetëve (Alberti, Besari dhe Genti).
- * Përgjigje në pytjet e dërguara nga Jeta Xharra.
- * Përpilimi i projekt propozimeve: rr. "Edit Durham" , rr. "Nënë Tereza" , fshati "Zhur" , fshati "Landovicë pjesa e eperme" në Prizren dhe lagja e Bajraktarve në Suharekë.
- * Vlersimi i kontratave në Prokurimit.
- * Mbikqyrje të projekteve: Rr. "De Rada" , "Nënkalaja" , "Φ400 mm" , rehabilitimi i kaptazhës "Sozi" , riparimi i objektit të Filtrat të gjitha në Prizren dhe Rr. "Xhavit Sylja" në Suharekë.
- * Vizita të rregullta në teren në kuadër të mbikqyrjeve.
- * Takim pune në K.Komunal me Ejupin, Fejsalin dhe Hatixhen për realizimin e projekteve të përbashkëta dhe atë që janë në plan nga K.Komunal si dhe mundësia e vazhdimi i bashkëpunimit ndërmjet dy insitucioneve.
- * Matje gjeodezike dhe aktivitete të ndryshme profesionale për nevoja të kompanisë.
- * Pasurimi i GIS-it me të dhëna.
- * Aktivitetet e grupeve janë të paraqitura në table.

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajve Korrik – Shtator, 2022	
Kalibrim i ujëmatësave (Bazhdarim)	238	riparime të ujëmatësave
	7	ekspertiza
Ndërrimi i ujëmatësave (D-M)	611	vizita të konsumatorët
	316	ndërrime të ujëmatësave
	90	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Detektimit të rrjetit	224	detektive
	165	defekte të gjetura
	5,620 m	rrjet i detektuar
Bllombimit	535	bllombim dhe kontrata
	1,120	inspektim sipas kërkesave të kons. – dera mbyllur
	35	kërkesa nga konsumatorët për bllombim

	6	konsumatorët që duhet të ndërrohet ujëmatësi
	34	konsumatorët që duhet zëvendësuar ujëmatësi
	1	konsumatorëve që duhet ndërruar ujëmatësi
	3	konsumatorët që duhet të regjistrohen

Raporti mbi cilësinë e ujit të pijes për muajt Korrik - Shtator 2022

Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në qytet si dhe kontrollimi i klorit në fshatra.

Marrja e mostrave sipas planit të monitorimit.

Kontrolli permanent i kualitetit të ujit në burime si dhe sasinë e cila shfrytëzohet.

Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorifikimit mbi mbarvajtjen e procesit dhe paisjeve.

Gjithashtu së bashku me puntorët e firmës „Diamanti” dhe inxhinierin e tyre kemi angazhu që të fusim në funksion sistemin e klorinimit në Vërmicë në mënyrë digjitale, po pa sukses edhe kësaj radhe dhe u pajtuam që për momentin të fusim në funksion në mënyrë analoge deri sa të vijmë ekspertat nga Shqipëria që pastaj të kthejmë në digjitale.

Furnizim i stacioneve të klorifikimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.

Në stacionin e klorinimit në Zhur ishim për ta ndërruar aparatin e klorinimit pasi ai i mëparshmi ishte djegur nga rrufeja.

Në Kushnin është rregulluar i gjithë rrjeti i rrymës dhe është vënë në funksion edhe procesi i klorinimit me aparatura të reja, pasi rrjeti dhe aparatat kishin pësuar dëmtime nga rrufeja.

Takim pune në Gjakovë me IKSHP dhe përfaqësuesen nga ARRU-ja, mbi finalizimin e Planit operacional të monitorimit të cilësisë së ujit.

Analizat Bakteriologjike, Korrik - Shtator / 2022, Lad.i kompanisë

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave		Nr. i mostrave që nuk përgjigjen	
		Bakteriologjike	Kimike	Bakteriologjike	Kimike
Prizren	Burim	14	14	12	0
	Ujësjiellës	29	29	1	0
Suharekë	Burim	5	5	4	0
	Ujësjiellës	17	17	1	0
Dragash	Burim	7	7	7	0
	Ujësjiellës	7	7	0	0
Malishevë	Burim	4	4	4	1
	Ujësjiellës	15	15	1	0
Totali		196		3	0

Vrejtje: 1) Në burim, uji i patrajtuar ; 2) Ujësjiellës, uji i trajtuar

Analizat Bakteriologjike, ISHP-Prizren, Korrik - Shtator / 2022

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	6	0
	Ujësjiellës	208	0
Suharekë	Burim	2	0
	Ujësjiellës	32	0
Dragash	Burim	2	0
	Ujësjiellës	14	4
Malishevë	Burim	2	0
	Ujësjiellës	28	0
Totali		294	4

Vrejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësjiellësit është 282 mostra, ku 4 prej të cilave nuk i përgjigjen standarteve të ISHP.

1.1.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas herëshme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

1.1.4 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Te gjitha defektet ne sistem te ujesjellesit dhe kanalizimit jane sanuar me kohe,
- Eshte percjell ne menyre permanente cilesia e ujit te pijes ne nivel regjional,
- Eshte pergaditur dhe miratuar strategjia e UPF-se.

1.1.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Monitorimi i furnizimit me uje te pijes ne gjith zonen e sherbimit,
- Monitorimi i cilesise se ujit te pijes ne nivel regjional,
- Vazhdimi i analizes se rrejtit te ujesjellesit dhe kanalizimit si dhe bartja e te dhenave ne GIS,
- Fillimi i implementimit te strategjise per uljen e UPF-se.

*Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrura për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.


- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjeter të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për dedektim.
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajn ujë në menyre që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve në sherbime dhe investime për sherbim sa me efikas të furnizimit me ujë të pijes.

II. RAPORT I DEPARTAMENTIT PËR KONSUMATORË

2.1 RAPORT I PERFORMANCËS TM2- TM3 -2022

2.1.1 NUMRI I KONSUMATORËVE

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA				
No.	Të dhënat	TM1- 2022	TM2-2022	TM3-2022
1	Shtëpiak	48,122	48,868	49,328
2	Ndryshimi		746	460
3	Ndryshi. %		1.55%	0.94%
4	Kome.-Indu.	6,179	6,214	6,256
5	Ndryshimi		35	42
6	Ndryshi. %		0.57%	0.68%
7	Institucional	342	344	345
8	Ndryshimi		2	1
9	Ndryshi. %		0.58%	0.29%
10	TOTAL	54,643	55,426	55,929
11	Ndryshimi		783	503
12	Ndryshi. %		1.43%	0.91%




2.1.2 FATURIMI - m3

TM1-TM2-TM3-TM4- 2022

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN


FATURIMI - m3				
No.	Të dhënat	TM1- 2022	TM2- 2022	TM3- 2022
1	Shtëpiak	1,428,376	1,716,705	2,014,433
2	Ndryshimi		288,329	297,728
3	Ndry. %		20.2	17.3
4	Kome.-Indu.	142,383	162,827	207,030
5	Ndryshimi		20,444	44,203
6	Ndry. %		14.4	27.1
7	Institucional	100,099	118,865	114,717
8	Ndryshimi		18,766	(4,148)
9	Ndry. %		18.7	(3.5)
10	TOTAL	1,670,858	1,998,397	2,336,180
11	Ndryshimi		327,539	337,783
12	Ndry. %		19.6%	16.9%



2.1.3 FATURIMI - €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN
TM1-TM2-TM3-TM4- 2022

FATURIMI - €				
No.	Të dhënat	TM1- 2022	TM2- 2022	TM3- 2022
1	Faturimi-€	1,145,917.64	1,329,503.81	1,520,804.41
2	Total- Shte.	883,999.34	1,032,683.30	1,188,091.26
3	Ndryshimi	(18,806.80)	148,683.96	304,091.92
4	Ndry. %	(0.06)	16.8%	34.4%
5	Total- kome.	170,354.35	188,432.82	227,495.42
6	Ndryshimi		18,078.47	57,141.07
7	Ndry. %		10.6%	33.5%
8	Total-Inst.	91,563.95	108,387.69	105,217.73
9	Ndryshimi		16,823.74	13,653.78
10	Ndry. %		18.4%	14.9%
11	Te tjera	21,464.94	14,252.58	16,819.32
12	Total	1,167,382.58	1,343,756.39	1,537,623.73
13	<i>Ndryshimi</i>		176,373.81	370,241.15
14	<i>Ndry. %</i>		15.1%	31.7%




2.1.4 ARKËTIMI -€

TM1-TM2-TM3-TM4 - 2022

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

No.	Të dhënat	TM1- 2022	TM2- 2022	TM3- 2022
1	Total- Shtëpiak	852,720.47	858,400.13	1,162,687.63
2	Ndryshimi		5,679.66	304,287.50
3	Ndry. %		0.7%	35.4%
4	Total-Komercial-Industrial	209,970.45	183,732.27	222,671.93
5	Ndryshimi		(26,238.18)	38,939.66
6	Ndry. %		-12.5%	21.2%
7	Total Institucional	64,787.51	114,001.79	136,494.69
8	Ndryshimi		49,214.28	22,492.90
9	Ndry. %		76.0%	19.7%
10	Total - ujë	1,127,478.43	1,156,134.19	1,521,854.25
11	Ndryshimi		28,655.76	365,720.06
12	Ndry. %		2.5%	31.6%
13	Te tjera	18,944.41	17,568.42	17,209.54
14	Ndryshimi		(1,375.99)	(358.88)
15	Ndry. %		-7.3%	-2.0%
16	TOTAL	1,146,422.84	1,173,702.61	1,539,063.79
17	Ndryshimi		27,279.77	365,361.18
18	Ndry. %		2.38%	31.13%



2.2 KOMENTET NGA DEPARTAMENTI PËR KONSUMATOR

2.2.1 AKTIVITETET KRYESORE

- Kemi nje faturim me te madh se ne krahasim me TM paraprak, si rezultat i rritjes së konsumit dhe rritjes së banorëve sezonal në zonën e shërbimit.
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor të secili konsumatorë.
- Janë vizituar nga lexuesit të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit.

2.2.2 RAPORT I ANKESAVE TEKNIKE DHE KOMERCIALE

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas prioritetit të tyre.
 - Janë shqyrtu ankesat teknike dhe komerciale në nivel rajonal:

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	791
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	791
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	221
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	221
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	221

2.2.3 RAPORT I INSPEKTIMIT

Kanë vazhduar kontrollet në teren të konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët dhe aktivitetet janë të prezentuara në tabelën e mëposhtme:

RAPORT I EKIPES SË INSPEKTIMIT

KRU "Hidroregjioni Jugor" sha

PERIUDHA

RAPORTUESE:

TM3 2022

Njesite operative	Shperndarja e njoftimeve paralajmeruese per permbarim	Konsumatoret e legalizuar	Lidhjet e paligjshme te zbuluara	Nr. i shkycjeve	Verifikimi i leximit te ujëmatësve	Nr. i leximeve te gabuara	Rastet e dorezuara per gjykatë	Vizita nga ankesat/kesat konsumatoreve	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	3,221	338	18	18	5,535	37	8	130	104,435.05
Suharekë	77	73	3	3	880	7	0	61	22,689.00
Malishevë	93	28	3	13	111	27	0	21	0.00
Dragash	0	12	7	5	74	3	0	1	50.00
TOTAL	3,391	451	31	39	6,600	74	8	213	127,174.05

2.2.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Moskontimi i disa ujëmatësve si rezultat i amortizimit të tyre apo arsyeve teknike tjera
- Mospagesa e obligimeve nga institucionet dhe nje pjese te borgjeve te kontraktuara nga nje pjese e madhe e konsumatoreve të cilët kanë nënshkru kontratë për pagesën e borxheve me kiste si rezultat i pamundësisë dhe rënies së fuqisë financiare .
- Mosgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës, bizneset që kanë falemintuar.

2.2.5 MASAT E REALIZUARA/MOSREALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Kemi një rritje të numrit të konsumatorëve si rezultat i pëlqimeve për kyqje dhe legalizimeve.
- Aktivitete me përmbaues privat (dalja ne teren me ekipet e kontrollës, identifikimi i adresave, identifikim i konsumatoreve, trashëgimtarëve të tyre etj), janë ndërprerë gjatë kësaj periudhe.
- Janë shpërnda njoftime para inicimit të procedurës përmbaimore në terrenet e inkasantëve në qytet.

- Jane vizituar konsumatorët të cilët kanë ngec në pagesën e kisteve nga kontratat për pagesën e borxhit me kiste, mirepo te kjo kategori janë dërguar mesazhe përmes telefonit ku është kërkuar pagesa kësteve të papaguara dhe obligimeve rrjedhëse.

2.2.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Vazhdimi i dërgimit të rasteve në përmbarim
- Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit te konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve te përmbauresi duke i ndërruar terrenet e inkasantëve.
- Vizita më të shpeshta te konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kisteve.
- Vazhdimësia e mbeshtetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat.
- Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit.

III. RAPORT I DEPARTAMENTIT PËR FINANCA

3.1 AKTIVITETE KRYESORE

Ky raport përfshinë disa aktivitete nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:


- Përgatitja e raporteve tremujore per TM2 2022;
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Përgatitja e raporteve mujore financiare, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore;
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajtë përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punsuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve; barazimi i të pagueshmeve;
- Plotesimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas ligjeve dhe formës standarte të kërkuar nga ATK, për muajtë përkatës, mujor e tremujor;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;
- Raportimet tremujore ndaj ARRU-së
- Raportimet tremujore ndaj njësisë për ndërmarrjet publike;
- Raportimet tremujore ndaj Agjensisë së Statistikave të Kosovës;

3.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

SHPENZIMET - €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN
2022

SHPENZIMET - €				
No.	Të dhënat	TM1- 2022	TM2- 2022	TM3- 2022
1	Total Shpenzimet Operative	977,527.96	983,194.72	1,038,591.99
2	Pagat	595,580.52	596,686	623,674
3	Rryma elektrike	247,718.67	230,183	225,051
4	Shpen. e derivateve	30,607.23	28,503	35,852
5	Mirem. dhe riparimet	35,506.28	34,245	36,785
6	Mirem. e automjeteve	10,031.68	11,501	14,221
7	Shpen.e taksave	27,017.02	19,614	29,586
8	Kemikaliet	1,269.66	8,626	12,869
9	Shpenzimet e tjera	29,796.90	53,837	60,552
2	Ndryshimi		5,666.76	55,397.27
3	Ndryshimi ne %		0.58%	5.63%



Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e III-të 2022, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të II-të 2022, janë më të larta;

Më poshtë do t' i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo uljes së tyre;

Në pozicionin e pagave kemi rritje të shpenzimeve në krahasim me tremujorin e kaluar; për shkak se në muajin korrik, për të gjithë punëtorët është dhënë shpërblym prej 50 euro për performancë të

mirë të kompanisë, si dhe në shtator me vendim të bordit është rritur shujta për ushqim. Pra këto janë dy arsyejet për rritje të shpenzimeve të kësaj kategorie;

Ndërsa tek pozicioni i energjisë elektrike kemi një rënie të shpenzimeve, në veçanti në njësinë e Prizrenit, pra kjo varet nga angazhimi i pompave që janë në funksion për nxjerrje të ujit sipas nevojës dhe konsumit si dhe përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje;

Te pozicioni i derivateve kemi një rritje të shpenzimeve, për shkak të angazhimit më të madh të makinerisë në kryerjen e aktiviteteve. Po ashtu edhe cimimi i derivateve ka qenë më i lartë në këtë tremujor;

Edhe te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, kemi një rritje të lehtë të kësaj kategorie të shpenzimeve, për shkak se në këtë tremujor ka pasur më shumë intervenime në mirëmbajtje se sa tremujori i kaluar;

Rritje kemi pasur te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve; në veçanti kemi rritje në Njësinë e Prizrenit dhe te Suharekës, pasi që në këtë tremujor, ka pasur nevojë më shumë për riparime të makinerisë;

Rritje kemi edhe tek shpenzimet e taksave, për shkak se në këtë tremujor, kemi më shumë lëndë të dërguara tek përmbaruesi, ndërsa shpenzimet e anëtarësisë në SHUKOS edhe ato të ARRU-së mbetën të njëjta;

Ndërsa te shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administrates, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e interesit, shpenzimet e trajnimit të stafit të kompanisë, shpenzimet e provizioneve etj, kemi rritje të kësaj kategorie;

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për këtë tremujor kanë qenë më të larta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyet e cekura më lartë. Pra, pozicioni i pagave, i derivateve dhe ai i taksave, kanë qenë pozicionet që kanë ndikuar më shumë në rritjen totale të shpenzimeve operative;

3.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

Edhe në këtë Tremujorsh Kompania i ka patur sfidat në aspektin financiar :

Obligimet ndaj KEK , për të cilin borgj ne kemi arrit marrëveshje me KEK-un për përmbushjen e obligimit për 12 vite . Obligimi vjetorë është 120,768.00 euro

Pamundësia e inkasimit të llogarive të arkëtueshme të vjetërsuara , ekziston edhe në këtë periudhë. Këto llogari të arkëtueshme edhe pse të proceduara tek përmbaruesi , ka vonesa relativisht të mëdha gjër sa arrinë realizimi i tyre .

Detyrimet kontigjente -kërkesat e punëtorëve ndaj kompanisë që kanë vendim gjykatë shuma 94,000.00 euro. Ekzistojnë ende si i tillë edhe në këtë periudhë tremujore .

3.4 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

Kompania i ka ndërmarrë të gjitha masat që edhe në këtë periudhë ti siguroj mjetet me kohë për borgjin ndaj KEK-ut në shumë 10,064.00 euro. Pasi që kemi marrëveshje të nënshkruar me KEK-un. Ne deri tani kemi arritur të përmbushim me sukses këtë marrëveshje .

3.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

Te bëhen përpjekje për inkasimin e llogarive të arkëtueshme para se ato të mundë të parashkruhen.

Të bëhet "presionë "ndaj përmbaruesve privat me qëllim të procedimit të lëndëve me ritëm më të shpejtuar.

TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

TM1-TM2-TM3- 2022

Treguesit e Performancës		TM1-2022	TM2-2022	TM3- 2022
Uje i faturuar-si perqindje	%	45.9%	46.2%	46.5%
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	54.1%	53.8%	53.5%
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	98.4%	87.0%	100.1%
Norma e arketimit - Amviserite	%	96.5%	83.1%	97.9%
Norma e arketimit - Komerical-Industrial	%	123.3%	97.5%	97.9%
Norma e arketimit - Institucional	%	70.8%	105.2%	129.7%
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.17	1.19	1.48
Staf per 1000 konsumatore	numer	5.96	5.87	5.78

3.6 TRANSAKSIONET KRYESORE- TM3-2022

10 pagesat me te medha nga Hidroregjioni Jugor per Operatoret TM3 2022

Data	Nr i dokumentit	Nr. I fat.	Emri I operatorit	Shuma
9/2/2022	NLB-P-00026972	FUR-01016	NPT Xerxa fat.111/08	81,295.80
7/5/2022	PCB-P-00176856	FUR-01661	K-ING sh.p.k. fat. 016/2022	53,065.10
9/2/2022	PCB-P-00180210	FUR-01788	PRO Constructions SH.P.K. fat.07/10/22	24,010.82
8/15/2022	BPBPZNPOS-003726	FUR-01039	KEK - Bunari I	22,973.60
9/22/2022	BPBPZNPOS-004010	FUR-01039	KEK - Bunari I	22,776.65
7/19/2022	BPBPZNPOS-003626	FUR-01039	KEK - Bunari I	22,200.16
8/3/2022	BPBPZNPOS-003686	FUR-01715	Pag.fat.420 TMS Mobile sh.p.k.	12,980.00
9/15/2022	NLB-P-00027056	FUR-01507	Petrol Company fat.4027/22	12,343.50
7/14/2022	PCB-P-00177478	FUR-01788	PRO Constructions SH.P.K. fat.004/22	11,727.88
8/3/2022	TEB-SH-000001826	FUR-01016	NPT Xerxa fat.117/07	11,018.80
TOTAL				274,392.31

10 pagesat me te medha ndaj Hidroregjioni Jugor per TM3 2022

Data	Kons	Emri I konsumatorit	Banka	Kategoria	Shuma
05.08.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	12,349.74
05.08.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	10,483.08
05.09.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	9,733.34
12.07.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	9,034.55
14.09.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	7,233.27
15.08.2022	KONS-0004042	Rasim Krusha	NLB Banka	SHEPI..Q	3,724.44
20.07.2022	KONS-0059600	Galeria Shopping Mall SH P K	Vllesa	LOKALET	2,474.13
03.08.2022	KONS-0029814	K.KOMUNAL.DREJT. PER AMB.DHE SHERB.PUBLIK	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	2,454.41
06.09.2022	KONS-0045253	Xhevati Spahija N.T."Spahia-Petrol"	ARKA-HASIME	LOKALET	2,446.43
08.09.2022	KONS-0037179	Agrokosova Holding Zyret-Shirokë	Banka per Bisnes	LOKALET	2,322.15
TOTAL					62,255.54

3.7 PASQYRAT FINANCIARE

Information EN	2022	2022	2022
	Tremujori 3	Tremujori 2	Tremujori 1
	Aktuale	Aktuale	Aktuale
Te Hyrat totale	1,626,012.11	1,435,241.49	1,461,311.41
Te Hyrat nga aktivitetit tregtar	1,537,399.86	1,343,756.39	1,167,382.60
Grantet Qeveritare			
Kostoja e Shitjes			
Profiti Bruto	1,537,399.86	1,343,756.39	1,167,382.60
Te hyra te tjera	88,612.25	91,485.10	293,928.81
Shpenzimet totale operative	1,527,683.07	1,336,895.25	1,331,435.67
nga te cilat:			
Shpenzimet e stafit	623,673.96	596,685.81	595,580.52
Zhvleresimi/ Amortizimi	218,357.85	218,357.85	218,357.85
Fitimi Operativ (EBIT)	98,329.04	98,346.24	129,875.74
Shpenzimet e Financimit			
Te hyrat e financimit			
Fitimi (Humbja) Tjeter Jo-Operativ			
Fitimi (Humbja) para Tatimit	98,329.04	98,346.24	129,875.74
Tatimi			
Fitimi (Humbja) pas Tatimit	98,329.04	98,346.24	129,875.74
Dividendi i deklaruar			
Asetet jo- rrjedhese	33,225,785.91	33,296,198.58	33,380,103.94
Asetet rrjedhese	6,528,693.58	6,339,208.14	6,317,697.33
nga te cilat:			
Inventari			
Llogarite e arketueshme	4,557,613.14	4,699,136.29	4,652,462.82
Parate	1,971,080.44	1,640,071.85	1,665,234.51
Asetet Totale	39,754,479.49	39,635,406.72	39,697,801.27
Gjithsej kapitali	15,855,703.51	15,659,654.66	15,659,654.66
Detyrimet jo-rrjedhese	20,368,587.20	19,893,343.86	19,844,102.45
Detyrimet rrjedhese	3,530,188.78	4,082,408.20	4,194,044.16
nga te cilat:			
Llogarite e pagueshme	1,986,992.48	2,541,772.97	2,641,000.69
Detyrimet Tatimore	1,543,196.30	1,540,635.23	1,553,043.47
Detyrimet Totale	23,898,775.98	23,975,752.06	24,038,146.61
Kontroll (check) per bilancin e gjendjes			
Paraja Neto e gjene. nga aktivi. Ope			
Paraja Neto e gjene. nga akti. investive			
Paraja Neto e gjene. nga akti financuese			
Grantet/ Subve./ Transfe. te Qeverise			
Grantet/ Subve/ Trans. kapi te Qeverise			
Rritja/ Zvog. Neto ne Huate Qeveritare			
Injeksionet e Kapitalit te Qeverise			
Numri i punetoreve	326	328	325

VI. RAPORT I DEPARTAMENTIT TE UN-ITUN

4.1 FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN

- Grumbullimin e ujerave të ndotura për qytetin e Prizrenit, Malishevës Suharekës dhe Dragashit përmes sistemeve ekzistuese dhe sistemeve të reja në ndërtim e sipër,
- Mirëmbajtjen e ujerave të ndotura për qytetin e Prizrenit, Malishevës Suharekës dhe Dragashit përmes sistemeve ekzistuese dhe sistemeve të reja në ndërtim e sipër,
